




Rama në fermën eksperimentale në Cërrik: Kemi burime të shumta, fokus tek inovacioni dhe eksperiencat më të mira

Faqe 5



Grurë, misër, lopë, qumësht: Subvencionet në bujqësi 77.5 milionë euro për vitin 2026

Faqe 7



Grumbulluesit dhe përpunuesit bujqësorë, nën monitorim të shtuar për respektimin e faturimit tatimor

Faqe 6



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit maj 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 533  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# UNIDO DHE SECO MBËSHTESIN SHQIPËRINË NË NDËRTIMIN E NJË SEKTORI MË DIGJITAL, KONKURRUES DHE TË PËRPUTHSHËM ME STANDARDET E BE-SË

## NJË HAP DREJT BUJQËSISË MODERNE DHE STANDARDEVE EUROPIANE PËRMES DIGJITALIZIMIT DHE AI

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të me NVM (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

**Programi Global Për Cilësi dhe Standarde**

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



**“Dyfisho sipërmarrjen tënde”, Yzeiraj për ATSH-në: Shteti garanton deri në 70% të kredive për të nxitur investimet e bizneseve**



Faqe 4

**INVESTIM**

**Peleg: Partneriteti Shqipëri–Izrael sjell inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në bujqësi**

Faqe 5



**Rregulla të rrepta për peshkimin dhe akuakulturën, ministria e Bujqësisë nis monitorimin me 6 faza për kontratat në të gjithë vendin**

Faqe 12

**TEMA TË DITËS**

- EU4Municipalities II, Demo: 11 milionë euro grante dhe asistencë teknike për nfrastukturën lokale dhe digjitalizimin Fq.6
- Qendra e Ekselencës Bujqësore në Cërrik, Salla: Forcimi i lidhjes mes arsimit profesional dhe praktikës në terren Fq.6
- AKU: 253 operatorë ushqimi në proces vlerësimi dhe kategorizimi Fq.4
- Jaupaj: 40 milionë euro për Shqipërinë nga Fondi Global i Mjedisit Fq.10
- Kërpudhat në Krahinën e Oparit - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

**MARRËVESHJE**

**Zgjidhet ngërçi për importin e verës italiane, Shqipëria dhe Italia dakordësojnë procedurat teknike**



Faqe 4

## HISTORI SUKSESI

# Nga Kavaja deri në Sarandë, “Eli Eksport” lidh 400 fermerë të kastravecit konishon me tregjet ndërkombëtare

Në zemër të Myzeqesë, aty ku toka është bujare dhe puna në serra nuk ndalet thajse asnjë ditë të vitit, një model bashkëpunimi mes fermerëve dhe sipërmarrjes po jep rezultate konkrete.

Pika e grumbullimit “Eli Eksport”, e ngritur në Lushnjë, është kthyer në një hallkë të rëndësishme që lidh prodhimin vendas me dhjetëra tregje europiane, duke garantuar shitje të sigurt dhe të ardhura të qëndrueshme për qindra familje.

## Një rrjet që rritet çdo vit nga Kavaja në Sarandë

Nga Kavaja në Poliçan e deri në Sarandë, mbi 400 fermerë janë bërë pjesë e bashkëpunimi me pikën e grumbullimit “Eli Eksport”, duke kultivuar më shumë se 100 hektarë serra me kastravec konishon, një kulturë e vogël në përmasa,

synojmë të arrijmë në 8 mijë tonë prodhim në vit, që shkon për eksport”, thotë Iliri.

Sipas tij, rritja është e lidhur drejtpërdrejt me kontratat e sigurt dhe bashkëpunimin afatgjatë me fermerët.

“Ajo që e bën këtë model tërheqës për fermerët është siguria që u ofron: treg i garantuar, çmime të qëndrueshme dhe pagesa të rregullta përmes bankës. Ndryshe nga tregu i lirë, ku luhatjet janë të shpeshëta, kontratat e bashkëpunimit u japin fermerëve besim për të investuar dhe zgjeruar prodhimin”, na tregon Iliri.

## Eksporte në 80 fabrika europiane. Cilësi e lartë “zero kthime” në eksport

Kastravec konishon i prodhuar në serrat e Myzeqesë ndjek një proces të rreptë kon-

për zgjerimin e eksporteve në tregjet me vlerë të shtuar ku dhe kërkesat po vijnë gjithë e në rritje për këtë varietet.

Sipas tij, kjo arritje i adresohet punës rigorozë që bëjnë agronomët dhe ekspertët e “Eli Eksport” në çdo hap të prodhimit, nga fara të cilën fermerët e marrin të subvencionuar nga kompania, kontrolli për përdorimin e inputeve, e deri në tregtim. Ndërsa analizat laboratorike kryhen rregullisht në laboratorë të certifikuar në Bari të Italisë.

Prodhimi nis me mbjelljen në mars, vijon me grumbullimin nga mesi i prillit dhe kulmon gjatë verës, kur nga kjo pikë nisen deri në 5-6 kamionë në ditë drejt Europës, me një volum që arrin deri në 100 tonë në ditë.

## Fermeri Ledian Kushi: “Shitja dhe pagesa janë të sigurt, kemi stabilitet”

Për fermerët, ky model i ri i bashkëpunimit bujqësor ka sjellë stabilitet dhe garanci në shitje. Ata theksojnë se ndryshimi më i madh është siguria financiare dhe kontraktuale.

Në fshatin Gorrenjë të Lushnjës, fermeri Ledian Kushi është një nga bashkëpunëtorët e pikës së grumbullimit “Eli Eksport”, i cili prej tre vitesh kultivon perime për eksport, me fokus te kastravec konishon për turshi.

Ledianin e gjetën tek pika e grumbullimit, teksa po shkarkonte prodhimin e mbledhur nga serrat e tij.

Ai na tregoi se aktualisht zotëronte rreth dy hektarë serra, të ngritura me mbështetjen e AZHBR përmes programit IPARD 2, ku kultivon produktet të ndryshme bujqësore, ndërsa dy vitet e fundit falë bashkëpunimit me “Eli Eksport” kishte gjashtë dynymë serra të mbjella me kastravec për eksport.

“Ndihe mi mirë sepse është një produkt që shitet, na krijon të ardhura të kënaqshme. Shitja është e sigurt, pagesa është e sigurt”, shprehet fermeri.

Sipas tij, bashkëpunimi me

kompaninë ka sjellë stabilitet në prodhim dhe treg.

“Bashkëpunimi që kemi nisur është një aktivitet i qëndrueshëm dhe ka siguri në treg dhe ecuri. Kemi tre vite që bashkëpunojmë dhe synojmë ta zgjerojmë më tej”, thotë Kushi.

Ai thekson gjithashtu ndryshimin mes tregut të lirë dhe kontratave të bashkëpunimit.

“Deri dje kemi punuar në treg të hapur, por ai nuk është asnjëherë i sigurt, sepse ka luhatje në shitje, pagesa dhe fitime. Kurse me kontratën e bashkëpunimit që kam sot me pikën e grumbullimit, çdo gjë është e sigurt dhe e rregullt”, shprehet ai.

## “Kam katërfishuar prodhimin” – dëshmia e fermerit nga Krutja

Lili Koço, fermer nga Krutja e Lushnjës, tregon për përvojën e tij shumëvjeçare në bujqësi dhe ndikimin që ka sjellë bashkëpunimi me kompaninë “Eli Eksport” në fermën e tij.

“Jam një nga fermerët e vjetër të zonës dhe më parë kam punuar specialist i bujqësisë në kooperativë. Me këtë model që është krijuar ndihem sikur jam në një kooperativë të tipit të lartë të prodhimit bujqësor, nga mënyra si menaxhohet produkti, si jepet informacioni për teknologjitë, përdorimi i inputeve bujqësore, deri te shitjet”, shprehet ai për ATSH-në.

Nushi thekson se bashkëpunimi me kompaninë ka sjellë rritje të ndjeshme të prodhimit dhe siguri në treg.

“Në fermën time prodhoj kastravec dhe është viti i katërt që bashkëpunoj me kompaninë “Eli Eksport”. Thajse kam katërfishuar prodhimin. E kam nisur me 1 dynym dhe sot kam 5 dynymë. I gjithë prodhimi është i kontraktuar dhe i shitur”, thotë ai.

Sipas tij, modeli i bashkëpunimit i ka dhënë stabilitet ekonomik dhe motivim për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit.

“Ky bashkëpunim na pëlqen dhe, megjithëse jam në pension, dua të shtoj prodhimin, sepse rrit të ardhurat”, përfundon fermeri.

## Zgjerimi drejt përpunimit dhe ciklit të plotë bujqësor

Iliri thotë se synimi i radhës është zgjerimi i aktivitetit drejt përpunimit të produkteve bujqësore, për të rritur vlerën e eksportit.

“Dua të zgjeroj magazinën dhe përpunimin, që të mos eksportojmë vetëm produkte të freskëta, por edhe të përpunuara. Kjo rrit vlerën “Made in Albania” dhe të ardhurat e fermerëve”, thekson ai.

Aktualisht, pas kastravecit, aktiviteti i pikës së grumbullimit vijon me klementinën (mandarinën) dhe lakrën e Brukselit, duke krijuar një cikël të plotë sezonal eksporti dhe një model të qëndrueshëm bashkëpunimi në bujqësi.

Në Myzeqe, “Eli Eksport” po dëshmon se me kontrata të qarta, standarde të larta dhe bashkëpunim të ngushtë me fermerët, bujqësia shqiptare mund të jetë konkurruese në tregjet më të kërkuara të Europës.

Kompania “Eli Eksport” në Lushnjë përbën një faktor të rëndësishëm për qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të zonës, duke u krijuar fermerëve mundësi punësimi, të ardhura të qëndrueshme për familjet e tyre dhe kushte për të jetuar e punuar pranë komunitetit ku kanë ndërtuar jetën e tyre.

Modeli i ciklit të mbyllur që ka ngritur kjo kompani me fermerët në zonën e Lushnjës përfaqëson një shembull të formalizimit dhe organizimit të zinxhirit bujqësor, ashtu sikurse kërkohej sot edhe në tregun europian, duke i “ndjekur” fermerët hap pas hapi, nga mbjellja, prodhimi dhe kontrolli i cilësisë, deri te grumbullimi, eksporti dhe pagesa e prodhimit.

Kompania garanton blerjen e prodhimit të fermerëve, ndërsa pagesat kryhen në mënyrë të formalizuar përmes bankës, çka krijon siguri financiare për familjet fermere dhe transparencë në të gjithë procesin.

Ky model ka krijuar një cikël të konsoliduar prodhimi për produktin e kastravecit “Konishon”, duke siguruar standarde cilësie dhe akses në tregjet e eksportit.

E veçanta e këtij formalizimi është se u hap rrugë fermerëve të përfitojnë nga masa mbështetëse e qeverisë për vitin 2026, që parashikon rimbursimin në masën 10% të faturës tatimore. Kjo politikë synon të lehtësojë kostot e prodhimit për fermerët dhe të nxisë më tej formalizimin e sektorit bujqësor.

Pra krahas tregut të sigurt të shitjes, në këtë mënyrë, modeli i ndërtuar nga “Eli Eksport”, jo vetëm që forcon formalizimin dhe garanton treg për prodhimin vendas, por gjithashtu u krijon fermerëve mundësi konkrete për të përfutur nga skemat e reja fiskale mbështetëse të qeverisë.

Formalizimi me NIPT i fermerëve, i nxitur nga ky model bashkëpunimi me pikën grumbulluese për eksport, është i domosdoshëm për të qenë pjesë e tregut konkurrues dhe për të pasur akses në mundësi të reja eksporti, sidomos drejt Bashkimit Europian.

Sipas vendimit të qeverisë fermerët që shesin prodhimet e tyre bujqësore tek grumbulluesit, përpunuesit apo agroturizmet e certifikuara duhet të nisin grumbullimin e autofaturave, në mënyrë që të përfitojnë kompensimin 10% nga skema e re e TVSH-së.

“Për çdo produkt bujqësor që fermerët shesin me faturë do të përfitojë 10% rimbursim TVSH-je. Kjo shumë do të llogaritet e do t’u kthehet periodikisht nga qeveria. Ne jemi të interesuar të garantojmë që puna e fermerit të shpërblehet dhe që tregu të jetë sa më i formalizuar dhe i drejtë. Formalizimi nuk është vetëm për të marrë 10% rimbursim. Ai na hap dyert që produktet tona made in Albania të njihen në treg, të jenë konkurruese me çmim dhe cilësi, dhe të përputhen me standardet e BE-së”, theksoi sipërmarrësi Ilir Rukaj.

Shqipëria është kthyer në eksportuesen kryesore të këtij kultivari në rajon. Në vitin 2025 u eksportuan 6500 tonë, ndërsa gjatë vitit 2026 pritet të kalohen 8500 tonë, teksa mbi 70 fabrika në Bashkimin Evropian përpunojnë produktin myzeqar.



por me vlerë të madhe në eksport dhe shumë e kërkuar nga tregjet e huaja.

Ekipi i ATSH-së e vizitoi nga afër këtë sipërmarrje ku u njoh me punën e palodhur të fermerëve dhe sipërmarrësit Ilir Rukaj, që na tregoi se aktivitetin e ka nisur në shkallë të vogël, por që e ka zgjeruar ndjeshëm në pesë vitet e fundit.

“Kam 20 vite që merrem me eksportin e fruta-perimeve, por 5 vitet e fundit jam fokusuar te kastravec konishon. Aktiviteti ka ardhur duke u zgjeruar gradualisht. Fillimisht e nisëm me rreth 15 hektarë, ndërsa sot kemi mbi 100 hektarë serra dhe

trolli, nga fara deri në eksport. Rezultati është domethënës: në pesë vite eksporti nuk është kthyer asnjë ngarkesë për shkak të problemeve me cilësinë apo mbetjet e pesticideve.

Iliri na tregon se produktin shqiptar të kastravecit konishon e eksporton në rreth 80 fabrika europiane, në vende si Franca, Polonia, Zvicra, Çekia, Italia, e tjerë në bashkëpunim me një kompani austriake.

“Kemi kërkesë të lartë nga tregjet për sasi konishoni dhe deri tani kemi zero kthime në eksport, sa i takon mbetjeve të pesticideve në produkt”, thekson Iliri, teksa shton se kjo është garanci për cilësinë dhe jep akses



## UNIDO DHE SECO MBËSHTESIN SHQIPËRINË NË NDËRTIMIN E NJË SEKTORI MË DIGJITAL, KONKURRUES DHE TË PËRPUTHSHËM ME STANDARDET E BE-SË

## NJË HAP DREJT BUJQËSISË MODERNE DHE STANDARDEVE EUROPIANE PËRMES DIGJITALIZIMIT DHE AI

*Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të me NVM (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare*

**T**ransformimi digjital dhe përdorimi i inteligjencës artificiale po shndërrohen në faktorë kyç për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë së vendeve që synojnë integrimin në Bashkimin Europian. Shqipëria, me një ekonomi ku bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm, po përballet me nevojën për modernizim, rritje të produktivitetit dhe përmbushje të standardeve evropiane.

Në këtë proces, një rol të rëndësishëm po luan United Nations Industrial Development Organization, e cila përmes Programit Global për Cilësinë dhe Standartet – GQSP Albania, financuar nga Swiss State Secretariat for Economic Affairs, po mbështet iniciativa që lidhen me inovacionin, digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjive të avancuara në sektorin agro-ushqimor.

**Në një kohë kur tregjet evropiane kërkojnë produkte të sigurt, të gjurmueshme dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare, digjitalizimi nuk është më vetëm një element modernizimi, por një domosdoshmëri për të rritur cilësinë dhe aksesin në tregje.**

### Teknologjia si mbështetje për cilësinë dhe standartet

Bujqësia shqiptare ka kaluar një periudhë transformimi gjatë viteve të fundit. Investimet në sera moderne, agropërpunim, teknologji ujitjeje dhe mekanikë bujqësore kanë sjellë rritje të prodhimit dhe zgjerim të eksporteve. Megjithatë, sfidat mbeten të shumta.

Fragmentimi i tokës, mungesa e standardizimit, kostot e larta të prodhimit dhe vështirësitë për të hyrë në tregjet evropiane kërkojnë një qasje të re zhvillimi. Pikërisht këtu hyn në lojë transformimi digjital.

Përdorimi i teknologjive inteligjente në bujqësi po ndryshon mënyrën se si prodhohet, monitorohet dhe tregtohet ushqimi. Fermerët sot mund të përdorin sisteme digjitale për të kontrolluar temperaturën dhe lagështinë në sera, për të menaxhuar ujitjen me efikasitet më të lartë apo për të analizuar të dhënat e prodhimit në kohë reale.

Inteligjenca artificiale po ndihmon gjithashtu në:

- parashikimin e sëmundjeve të bimëve,
- optimizimin e përdorimit të plehrave dhe inputeve,
- uljen e humbjeve në prodhim,
- si dhe përmirësimin e vendimmarrjes në fermë.

Sot, cilësia nuk lidhet vetëm me produktin final. Ajo lidhet me të gjithë zinxhirin e vlerës — nga prodhimi në fermë, monitorimi i kushteve klimatike dhe trajtimi pas-vjeljes, deri të ruajtja, përpunimi, paketimi dhe dokumentimi i proceseve.

Pikërisht për këtë arsye, përdorimi i sistemeve inteligjente të monitorimit, kamerave me AI dhe platformave digjitale po ndihmon sektorin agro-ushqimor të kalojë nga një model tradicional drejt një qasjeje moderne, të bazuar në të dhëna dhe standarde.

### Mbështetja e UNIDO dhe SECO për digjitalizimin e sektorit agro-ushqimor

Në kuadër të GQSP Albania, UNIDO dhe SECO kanë mbështetur implementimin e 9 pajisjeve inteligjente me AI për monitorimin e kulturave bujqësore në NVM dhe Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (ATTC) në disa rajone të Shqipërisë.

Këto sisteme moderne mundësojnë:

- mbledhjen e të dhënave në kohë reale,
- monitorimin e parametrave agrometeorologjikë,
- analizimin e kushteve klimatike dhe riskut,
- si dhe krijimin e parashikimeve për të mbështetur vendimmarrjen e fermerëve dhe bizneseve.

Përmes këtyre teknologjive, fermerët dhe NVM-të mund

të monitorojnë indikatorë të rëndësishëm si:

- temperatura,
- lagështia relative,
- reshjet,
- lagështia në gjethe,
- dhe faktorë të tjerë që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe sigurinë e prodhimit.

Këto pajisje inteligjente ndihmojnë bizneset të reduktojnë riskun, të parashikojnë problematikat dhe të përmirësojnë menaxhimin e prodhimit, duke krijuar një qasje më të avancuar ndaj cilësisë, standardeve dhe konkurrueshmërisë.

Në të njëjtën kohë, teknologjitë po ndihmojnë edhe institucionet, shërbimet këshillimore dhe ekspertët që të kenë më shumë të dhëna dhe analiza për mbështetjen e fermerëve dhe agrobizneseve.

### Digjitalizimi dhe siguria ushqimore

Një nga sfidat më të mëdha për sektorin agro-ushqimor mbetet garantimi i sigurisë ushqimore dhe përputhshmërisë me standartet evropiane.

Tregjet e Bashkimit Europian kërkojnë produkte me standarde të larta cilësie, me dokumentacion të plotë dhe me procese të kontrolluara prodhimi. Digjitalizimi krijon mundësinë që çdo fazë e prodhimit të monitorohet dhe të dokumentohet, duke rritur besueshmërinë e produkteve shqiptare.

Një nga aspektet më të rëndësishme është gjurmueshmëria e produkteve.

Përmes platformave digjitale dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave, bizneset mund të:

- dokumentojnë proceset e prodhimit,
- ndjekin gjurmueshmërinë e produktit,
- ruajnë evidencat për inspektime dhe certifikime,
- monitorojnë parametrat kritikë të cilësisë,
- dhe të përmirësojnë menaxhimin e riskut.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për standarde si:

- GLOBALG.A.P.
- HACCP
- ISO 22000
- standartet organike të BE-së
- dhe sisteme të tjera të certifikimit ndërkombëtar.

Përmes teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, bizneset shqiptare mund të kalojnë nga procese manuale dhe të fragmentuara drejt sistemeve moderne dhe të integruara të menaxhimit të cilësisë.

### Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

Përveç investimeve në teknologji, një element thelbësor mbetet zhvillimi i aftësive profesionale dhe rritja e kapaciteteve njerëzore.

UNIDO po mbështet gjithashtu trajnimin e fermerëve, NVM-ve dhe institucioneve në përdorimin e teknologjive të reja dhe sistemeve moderne të menaxhimit të cilësisë.

Shumë fermerë shqiptarë ende mbështeten te metodat tradicionale të prodhimit dhe kanë nevojë për njohuri të reja për të përfituar nga avantazhet e digjitalizimit. Trajnimet mbi përdorimin e aplikacioneve inteligjente, analizën e të dhënave dhe menaxhimin modern të fermës konsiderohen thelbësore për rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë.

### Një hap drejt integritit evropian

Bashkimi Europian e konsideron digjitalizimin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe të bujqësisë moderne.

Në kuadër të procesit të integritit, Shqipëria duhet të harmonizojë standartet dhe politikat e saj me ato evropiane. Kjo do të thotë:

- më shumë investime në teknologji,
- laboratorë modernë,
- sisteme monitorimi,
- platforma digjitale,
- dhe infrastrukturë cilësie.

Transformimi digjital dhe përdorimi i AI nuk lidhen vetëm me modernizimin e prodhimit, por edhe me rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare dhe përgatitjen për tregun evropian.

Përmes partneriteteve me institucionet shqiptare, universitetet, NVM-të dhe sektorin privat, UNIDO po kontribuon në krijimin e një ekosistemi më inovativ dhe më të orientuar drejt teknologjisë dhe standardeve.

Objekti është që prodhimi shqiptar të mos konkurrojë vetëm me çmim, por edhe me cilësi, siguri ushqimore, gjurmueshmëri dhe standarde evropiane.

### E ardhmja e sektorit agro-ushqimor shqiptar

Transformimi digjital nuk është më një zgjedhje, por një domosdoshmëri për të ardhmen e bujqësisë shqiptare.

Në një treg global gjithnjë e më konkurrues, përdorimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive moderne mund të bëhet çelësi për:

- rritjen e produktivitetit,
- uljen e kostove,
- përmirësimin e cilësisë,
- dhe zgjerimin e eksporteve.

Shqipëria ka potencial të madh në sektorin agro-ushqimor falë klimës së favorshme, tokës bujqësore dhe traditës në prodhim. Por për të përfituar plotësisht nga ky potencial, sektori duhet të ecë në hap me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut evropian.

Mbështetja e UNIDO dhe SECO po krijon mundësi konkrete që bujqësia shqiptare të hyjë në një fazë të re zhvillimi, ku teknologjia, inovacioni, cilësia dhe standartet të jenë faktorët kryesorë të suksesit dhe integritit evropian.



## Salla: Forcojmë kapacitetet laboratorike për sigurinë fitosanitare

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) po vijon punën për forcimin e kapaciteteve laboratorike në diagnostikimin e dëmtuesve të bimëve, në funksion të rritjes së sigurisë fitosanitare dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, bëri të ditur se, me mbështetjen e UNIDO, Qeverisë së Zvicrës dhe ekspertëve ndërkombëtarë, specialistët shqiptarë po trajnohen në validimin e metodave diagnostikuese për mbrojtjen e prodhimit bujqësor.

Sipas ministrit Salla, këto procese synojnë mbrojtjen e prodhimit bujqësor, rritjen e sigurisë së kulturave bujqësore dhe forcimin e sigurisë ushqimore në vend.



Përmes rritjes së kapaciteteve teknike dhe laboratorike, synohet gjithashtu rritja e besueshmërisë së produkteve

shqiptare në tregjet ndërkombëtare, në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare të sigurisë fitosanitare.

## Zgjidhet ngërçi për importin e verës italiane, Shqipëria dhe Italia dakordësojnë procedurat teknike



Shqipëria dhe Italia janë dakordësuar për zgjidhje teknike për problematikën që ka shoqëruar importin e verës italiane në vendin tonë, duke i hapur rrugë vijimit normal të procedurave për operatorët ekonomikë.

Në një njoftim zyrtar, Dogana Shqiptare bën të ditur se Agjencia e Doganave të Italisë ka pranuar propozimin e paraqitur nga

pala shqiptare për zgjidhjen e situatës aktuale që po prek importet e verës nga Italia, në përputhje edhe me legjislacionin italian në fuqi.

Sipas njoftimit, sqarimet teknike të detajuara mbi procedurat do të publikohen në faqen zyrtare të Doganave Shqiptare, ndërsa importuesit ftohen të vijojnë importet sipas rregullave në fuqi.

Prej fillimit të këtij viti, operatorët që importojnë verë nga Italia janë përballur me rritje të pagesës së akcizës, për shkak të mosaplikimit të diferencimit të parashikuar në legjislacion.

Kuadri ligjor shqiptar parashikon nivele të ndryshme akcize për verën e importuar, në varësi të kapacitetit prodhues të subjektit eksportues. Konkretisht, ligji bën dallim mes prodhuesve me prodhim vjetor deri në 10 mijë hektolitra dhe atyre me prodhim mbi këtë prag, çka në praktikë njihet si akcizë e diferencuar për verën.

Marrëveshja teknike mes dy administratave doganore synon të shmangë pengesat në procedurat e importit dhe të garantojë zbatimin korrekt të skemës së akcizës së diferencuar për operatorët që importojnë verë nga Italia.

## AKU: 253 operatorë ushqimi në proces vlerësimi dhe kategorizimi

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka nisur procesin e kategorizimit dhe vlerësimin për sigurinë ushqimore, për produktet me origjinë shtazore, qumështi, mishi, peshku dhe veza, si një masë për të përmbushur standardet e sigurisë së kërkuara nga procesi i integritetit në BE.

Drejtoresha e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Blerina Gjylameti tha në konferencën e parë Kombëtare të Industrisë së

Përpunimit të Qumështit se pas një skanimit që i është bërë sektorëve kanë nisur inspektimet nga trupa e AKU në stabilimente dhe fabrika.

“Do të verifikohen 253 operatorë për të parë se ku jemi. Në listë, verifikimet e inspektorëve do të përfshijnë komente të detajuara për të identifikuar ndryshimet e nevojshme. Në fund të raportit do të kemi të qartë se çfarë duhet të ndryshojë”, deklaroi ajo.

Gjylameti rikonfirmoi angazhimin e institucionit për përmbushjen e standardeve europiane të sigurisë ushqimore, duke e cilësuar këtë proces si pjesë të strategjisë kombëtare.

Konferenca shërbeu si një platformë bashkëpunimi mes industrisë dhe institucioneve, duke vënë theksin të rritja e cilësisë, sigurisë ushqimore dhe forcimi i kontrollit në zinxhirin e prodhimit dhe përpunimit të qumështit në vend.

## “Dyfisho sipërmarrjen tënde”, Yzeiraj për ATSH-në: Shteti garanton deri në 70% të kredive për të nxitur investimet e bizneseve

Qeveria shqiptare po finalizon një skemë të re mbështetëse për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, me synim rritjen e aksesit në financim dhe nxitjen e investimeve që rrisin produktivitetin e ekonomisë.

Nisma “Dyfisho sipërmarrjen tënde” bazohet në mekanizmin e garancisë sovra-

më interes për të bërë filtrimin e projekteve. Ne duam që ky filtrim të mbetet detyrë e sektorit privat, ndërsa shteti të lehtësojë aksesin në financim”, theksoi ai.

Yzeiraj shtoi se qëllimi i skemës është jo vetëm rritja e kreditimit, por edhe ulja e normave të interesit, duke e bërë financimin më të përbal-

mesme kanë përfituar kredi përmes kësaj skeme dhe kjo tregon se mekanizmi funksionon”, u shpreh ai.

Yzeiraj konfirmoi se skema aktuale do të jetë funksionale deri në fund të vitit, ndërsa më pas do të vlerësohet mundësia e zgjatjes së saj në varësi të rezultateve dhe nevojave të tregut.

Në lidhje me nismën e re “Dyfisho sipërmarrjen tënde”, ai tha se ajo është ende në fazë finalizimi teknik dhe po diskutohet në detaje me bankat tregtare.

“Ka ende disa elemente për t’u finalizuar. Kryeministri pritet ta prezantojë shumë shpejt këtë program, por aktualisht po diskutojmë detajet e fundit me sistemin bankar”, deklaroi Yzeiraj.

Ai bëri të ditur se fondi total i parashikuar për skemën është rreth 30 milionë euro, ndërsa efekti i saj në ekonomi pritet të jetë më i madh për shkak të mekanizmit të garancisë.

“Në varësi të nivelit të garancisë, që mund të jetë nga 50% deri në 70%, sasia totale e kredive që mund të mobilizohen në ekonomi mund të arrijë deri në 60 milionë euro”, tha ai.

Yzeiraj shtoi se një nga objektivat kryesorë është orientimi i kredive drejt investimeve që rrisin produktivitetin, si linjat e prodhimit, teknologjia dhe digitalizimi.

“Kreditë nuk do të përdoren për shpenzime operative si paga apo lëndë të para. Po ashtu, blerja e pasurive të paluajtshme nuk do të jetë qëllim kryesor, përveç rasteve kur përbën një pjesë të vogël të një investimi prodhues”, theksoi ai.

Në lidhje me normat e interesit, Yzeiraj sqaroi se ato do të jenë fleksibël dhe të lidhura me nivelin e garancisë dhe strukturën e investimit.

“Aktualisht, për sektorin bujqësor norma është rreth 2%. Në varësi të garancisë, ajo mund të variojë nga 2,5% deri në 3,5%. Sa më e lartë garancia, aq më e ulët norma e interesit”, u shpreh ai.

Zv.ministri Yzeiraj vuri në dukje se nisma është pjesë e një strategjie më të gjerë për përgatitjen e ekonomisë shqiptare për tregun e Bashkimit Europian.

“Qëllimi është që bizneset shqiptare të bëjnë një hap cilësor dhe të rrisin konkurrueshmërinë e tyre. Investimet në produktivitet dhe teknologji janë thelbësore për këtë proces”, deklaroi Yzeiraj.



përmes së cilës shteti shqiptar merr përsipër një pjesë të rrezikut të kredive të dhëna nga bankat tregtare, duke lehtësuar kushtet e kreditimit për sipërmarrjet private.

Në thelb, programi synon të adresojë një nga sfidat kryesore të bizneseve shqiptare, vështirësinë për të siguruar financim, sidomos për sipërmarrjet e reja dhe ato në sektorë si bujqësia, ku mungesa e kolateralit dhe formalizimi i pjesshëm e bëjnë më të vështirë aksesin në kredi bankare.

Në një intervistë për ATSH-në, zëvendësministri i Financave, Endrit Yzeiraj shpjegoi se skema ndërtohet mbi eksperiencat e mëparshme të garancive sovraane dhe synon të krijojë një instrument më të gjerë dhe më efikas për nxitjen e kreditimit në ekonomi.

“Dyfisho sipërmarrjen tënde” është një nismë që bazohet në eksperiencat e mëparshme të Ministrisë së Financave me garancitë sovraane. Shteti shqiptar garanton kreditë që kërkojnë sipërmarrësit në sektorin bankar, duke bërë që bankat t’i konsiderojnë ato më pak të rrezikshme dhe të jenë më të predispozuar për të dhënë kredi”, u shpreh Yzeiraj.

Ai sqaroi se në garancinë më të fundit, e cila lidhet me sektorin bujqësor, shteti mbulon deri në 70% të kredisë në rast mospagese, një nivel që sipas tij, është i qëllimshëm për të ruajtur ekuilibrin mes mbështetjes publike dhe rolit të bankave në vlerësimin e riskut.

“Nëse garancia do të ishte 100%, bankat nuk do të kishin

lueshëm për bizneset.

“Duke e pasur shtetin si garant, ulet perceptimi i rrezikut dhe bankat janë më të predispozuar të ofrojnë kredi me norma më të ulëta interesi. Në këtë mënyrë, përmirësohet edhe aksesimi i financës për sipërmarrjet”, tha ai.

Sipas tij, nevoja për një ndërhyrje të tillë vjen nga struktura aktuale e ekonomisë shqiptare, ku shumë biznese të vogla dhe të reja nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat tradicionale të bankave për kolateral.

“Sistemi bankar historikisht është bazuar shumë në kolateral. Kjo krijon vështirësi për bizneset e reja, që shpesh nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të garantuar kredinë. Për këtë arsye, ato mbeten më pak të financuara”, shpjegoi Yzeiraj.

Ai shtoi se problematika është e theksuar edhe në sektorin bujqësor, ku niveli i formalizimit, certifikimit dhe mekanizmit është ende në zhvillim, duke e bërë sektorin më të rrezikshëm në “sytë” e bankave.

“Niveli i ulët i formalizimit, mungesa e certifikimeve dhe digitalizimi i kufizuar kanë bërë që bankat ta perceptojnë bujqësinë si një sektor me risk më të lartë”, tha ai.

Megjithatë, sipas zëvendësministrit, eksperiencat e deritanishme me garancitë sovraane kanë qenë pozitive. Ai bëri të ditur se vetëm në sektorin bujqësor janë disbursuar rreth 8 milionë euro kredi në këta 4-5 muaj.

“Kemi një eksperiencë relativisht pozitive. Një numër sipërmarrjesh të vogla dhe të

## INVESTIME

# Rama në fermën eksperimentale në Cërrik: Kemi burime të shumta, fokus tek inovacioni dhe eksperiencat më të mira

Një model i ri i zhvillimit të bujqësisë moderne i ndërthurur me arsimin profesional po merr formë në Cërrik, përmes fermës eksperimentale të shkollës profesionale “Mihal Shahini”, një projekt i vënë në jetë nga MASHAV (Agjencia Izraelite për Zhvil-

erne bujqësore, si dhe hapësira të posaçme për leksione dhe trajnime me ekspertë vendas e ndërkombëtarë.

Ky investim përfaqëson gjithashtu një tjetër hap drejt modernizimit të infrastrukturës bujqësore në vend dhe nxitjes së një bujqësie më

ta, “ajo që na ka munduar për një kohë të gjatë ka qenë një fokus tek inovacioni dhe eksperiencat më të mira”.

“Duket si kopsht i një shtëpie, por është zemra e një ferme eksperimentale. Këtu bëhen eksperimente me kultura të ndryshme, ndërkohë që në anën tjetër janë edhe bagëtitë me të cilat punojnë nxënësit së bashku me pedagogët”, tha Rama.

Rama theksoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit me Universitetin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Natyrore të Vjenës (BOKU), një nga institucionet më prestigjioze në Evropë, me të cilin Universiteti Bujqësor i Tiranës

“Sot qëllimi rastësisht që unë të isha përpara se të vija këtu me ish rektorin e famshëm të Universitetit të BOKU-t të Vjenës, që është Universiteti i Bujqësisë, që është Universiteti i Zhvillimit Rural dhe i Burimeve të Natyrës ndër më të famshmit në Europë dhe me të cilin Universiteti ynë Bujqësor ka bërë një partneritet strategjik me synimin që deri në fund të kësaj dekade ne të kemi një njehsim të programeve me Vjenën dhe dekada e ardhshme të jetë dekada ku të gjithë studentët tanë të mund të marrin diploma të barasvlershme me diplomat e Universitetit BOKU të Vjenës.

“Edhe sot profesori më dha

edukuar edhe për të arritur të marrin dije cilësore nuk e lënë atë mundësi pa e shfrytëzuar dhe gjithë ato stereotipe të krijuara për vite të tëra lidhur me fshatin, me bujqësinë, me Universitetin Bujqësor bien si “kështjella rëre” kur një mundësi reale shfaqet dhe kur si rezultat i një pune të madhe të bërë në këto vite hap pas hapi me vështirësi pa pasur edhe shumë mjete financiare në dispozicion si fillim, krijohej kushtet që pas kësaj gjërat marrin një drejtim tjetër”, tha Rama.

Rama shtoi se “kjo është besoj unë edhe arsyeja pse ne kemi të gjitha shkaqet për

rëveshje e rëndësishme me Izraelin për të thelluar bashkëpunimin, me synim transferimin e më shumë dijes dhe eksperiencës në Shqipëri në fushën e bujqësisë moderne.

“Kështu që më vjen shumë mirë për këtë zhvillim kaq pozitiv në drejtim të bashkëpunimit për sa i përket fshatit, për sa i përket tokës, për sa i përket burimeve ujore dhe një bujqësie cilësore, dhe jam besimplotë se ky është vetëm një hap.

“Ndërkohë që siç e tha dhe ministri presim me padurim që të firmosim dhe një marrëveshje të rëndësishme me qeverinë e shtetit të Izraelit për të hapur një kapitull tjetër



lim), që synon të shërbejë si platformë edukimi, trajnime dhe demonstrimi për nxënësit dhe fermerët shqiptarë. Projekti përfaqëson një investim të rëndësishëm në arsimin profesional dhe një hap konkret drejt zhvillimit të një bujqësie të qëndrueshme, inovative dhe konkurruese përmes përdorimit të teknologjive moderne.

Ferma është konceptuar si bazë didaktike e shkollës profesionale, duke krijuar mundësi që nxënësit dhe fermerët të mësojnë dhe të aplikojnë në praktikë metoda bashkëkohore të kultivimit dhe menaxhimit bujqësor. Ajo ofron sera moderne të pajisura me sisteme inteligjente të kontrollit të klimës dhe ajrimit, sisteme të centralizuara ujëtujeje, kultivim hidroponik, ambiente të dedikuara për blegtorinë, pajisje mod-

efikase dhe më produktive, ndërsa shënon njëkohësisht edhe një kapitull të ri bashkëpunimi dhe zhvillimi mes Shqipërisë dhe Izraelit.

Këtë fermë të re e vizitoi Kryeministri Edi Rama, i cili u njoh nga afër me investimin e realizuar në bashkëpunim me MASHAV – Agjencia për Zhvillim e Izraelit, me mbështetjen e Ambasadës së Izraelit në Shqipëri dhe në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Rama u shpreh se Izraeli “sot është një vend që është një pasqyrë shembullore e asaj që mund të bëjë mendja e njeriut kur gjendet në situatën që të krijojë rrugë të reja dhe të gjejë shtigjet për t’i mbijetuar kushteve të pafavorshme gjeografike”.

Rama nënvizoi se, ndonëse vendi ynë ka burime të shum-



ka një partneritet strategjik.

Sipas Ramës synohet që “deri në fund të kësaj dekade të kemi një unifikim të programeve me Vjenën dhe dekada e ardhshme të jetë dekada ku të gjithë studentët atje të marrin diploma të barasvlershme me diplomat e BOKU të Vjenës. Po bëhet një reformë shumë kuptimplotë në atë universitet”.

Rama u shpreh se interesi i të rinjve për të studiuar në fushën e bujqësisë është rritur ndjeshëm.

një informacion të detajuar mbi ecurinë e reformës shumë kuptimplotë që po bëhet në atë universitet dhe mbi hapat e tjerë që duhen hedhur, por arsyeja pse e solla këtu këtë është se me shumë kënaqësi pashë që shifrat e interesimit për t’u bërë pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës nga ana e të rejave dhe të rinjve janë rritur në mënyrë të ndjeshme. Edhe kjo vjen si rezultat i faktit që vajzat dhe djemtë e këtij vendi kur shohin një mundësi për t’u



të qenë optimist edhe për këtë program, edhe për këtë shkollë, edhe për këtë bashki që ka hedhur hapa kurajoze edhe hapa të admirueshëm në drejtim të vënies në shfrytëzim të atyre që ofron sot teknologjia në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, në funksion të uljes së kostove, në funksion të rritjes së cilësisë së mjedisit dhe të pastërtisë së tij e kështu me radhë”.

Gjithashtu, Rama theksoi se pritet të firmoset një mar-

në këtë marrëdhënie që për ne është shumë e rëndësishme për të marrë sa më shumë dije dhe për të transferuar në Shqipëri sa më shumë eksperiencë nga ajo që e ka bërë atë vend një vend shembull, pararojë në inovacion edhe në të gjitha fushat, përfshirë edhe bujqësinë ku siç e thashë asgjë nuk ka qenë në favor të një zhvillimi të suksesshëm, në aspektin e asaj që shteti ka pasur në dispozicion një shkretëtire pa ujë”, tha Rama.

Kryeministri Edi Rama, ambasadorja e Izraelit në Shqipëri Galit Peleg, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, si dhe të ftuar të tjerë, zhvilluan në Cërrik një vizitë në fermën eksperimentale të shkollës profesionale “Mihal Shahini”.

Kjo fermë është realizuar nga Agjencia Izraelite për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (MASHAV) dhe synon të shërbejë si platformë edukimi, trajnime dhe demonstrimi për nxënësit dhe fermerët, duke u mundësuar përdorimin e metodave inovative në bujqësi dhe duke e kthyer këtë atë në një model bashkëkohor të zhvillimit rural dhe arsimit profesional.

Ambasadorja Peleg vlerësoi se ky projekt shkon përtej një investimi në infrastrukturë bujqësore, duke e cilësuar atë si një moment të rëndësishëm të partneritetit mes dy vendeve.

“Sot është më shumë se hapja e një ambienti bujqësor,

është momenti për të kremtuar fazën e partneritetit dhe bashkëpunimeve të përbashkëta dhe besimit të ndërsjellë që njohuria, inovacioni dhe bashkëpunimi mund të transformojnë jetë dhe komunitete”, u shpreh Peleg.

Ajo theksoi se MASHAV ka ndërtuar prej dekadash një filozofi zhvillimi të bazuar në bashkëpunim ndërkombëtar. “Që prej themelimit, agjencia izraelite për bashkëpunim dhe zhvillim ka punuar në mbarë botën me besimin se mënyra më e mirë për zhvillim është përmes partneriteteve të mirëfillta që fuqizojnë komunitetet për t’u dhënë atyre mundësi për të ndërtuar të ardhmen e tyre”, tha ambasadorja.

Duke folur për qasjen e projektit, Peleg nënvizoi rëndësinë

e aksesit të teknologjisë për të gjithë fermerët. “Theksi ynë ka qenë tek adaptimi i zgjidhjeve të mençura, jo vetëm



për ekonominë e mëdha dhe të avancuara, por edhe për fermat e vogla. Inovacioni ka

kuptim vetëm kur është i aksesueshëm”, nënvizoi ajo.

Ajo shtoi se njohuria ka vlerë vetëm kur ndahet dhe kur

sjell ndikim konkret. “Njohuria është fuqi vetëm kur ndahet me të tjerët dhe ka

ndikim kur arrin njerëzit. Kjo është filozofia e kësaj ferme ku jemi sot”, tha Peleg.

Sipas saj, në gjashtë muajt e fundit ferma është transformuar në një qendër inovative me tre sera moderne, pajisje të avancuara për mjeljen e bagëtive dhe një sistem vaditjeje me pika të kontrolluar nga teknologjia kompjuterike.

“Ne shpresojmë që kjo fermë të bëhet më shumë se një fermë eksperimentale dhe që fermerët dhe të rinjtë të vijnë këtu për të mësuar dhe për t’u frymëzuar për risitë e reja në bujqësi”, u shpreh ambasadorja, duke shtuar se qendra mund të shërbejë edhe si model didaktik për rajonin.

Ajo theksoi gjithashtu dimensionin historik të marrëdhënieve mes dy vendeve.

## Peleg: Partneriteti Shqipëri–Izrael sjell inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në bujqësi

“Kjo shënon një kapitull tjetër në marrëdhëniet e shkëlqyera dhe të qëndrueshme mes Shqipërisë dhe Izraelit, që kanë rrënjë historike që nga koha kur Shqipëria hapi zemrat për të strehuar hebrejtë gjatë Holokaustit”, theksoi Peleg.

Në përfundim, Peleg iu drejtua studentëve të shkollës profesionale, duke e cilësuar fermën si një trashëgimi për ta. “Kjo është e ardhmja juaj dhe ju do të kujdeseni për të, duke u bërë drejtues dhe prodhues të së ardhmes. ‘Ata që mbjellin me përpjekje do të korrin me gëzime’”, u shpreh ajo.

Ky projekt synon modernizimin e sektorit bujqësor në Shqipëri përmes teknologjive të reja, trajnimit profesional dhe krijimit të një modeli të qëndrueshëm zhvillimi rural, duke forcuar më tej bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Izraelit në fushën e inovacionit dhe bujqësisë.

## AKTUALITET

## Qendra e Ekselencës Bujqësore në Cërrik, Salla: Forcimi i lidhjes mes arsimit profesional dhe praktikës në terren

Në shkollën profesionale bujqësore "Mihal Shahini" në Cërrik u prezantua projekti "Qendra e Ekselencës Bujqësore", i realizuar në bashkëpunim me ekipin izraelit të Agjencisë Izraelite për Zhvillim, (MASHAV), një nismë që

sektorit bujqësor dhe forcimit të lidhjes mes arsimit profesional dhe praktikës në terren.

"Ky projekt i shërben jo vetëm studentëve dhe pedagogëve, por edhe fermerëve të zonës, duke sjellë teknologji dhe inovacion në bujqësi", u

do t'u mundësojë fermerëve akses në kohë reale përmes aplikacioneve dhe sensorëve inteligjentë, duke përmirësuar vendimmarrjen për vaditje, plehërim dhe menaxhim të prodhimit.

Salla shtoi se po zgjerohet mbështetja financiare për sektorin, përfshirë garancinë sovranë dhe instrumente të tjera mbështetëse për fermerët, ndërsa theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e zinxhirit të grumbullimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore.

Projekti në Cërrik përfshin sera moderne, pajisje të avancuara dhe sisteme të automatizuara të ujitjes, duke synuar të shërbejë si model demonstrues për bujqësinë shqiptare dhe si qendër reference për trajnimin e fermerëve dhe të rinjve në të gjithë vendin.

Salla tha se, "kjo nismë përbën një tjetër hap në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe forcimit të partneritetit me Izraelin në fushën e inovacionit dhe zhvillimit rural".



synon të shndërrojë institucionin në një qendër moderne edukimi, trajnimi dhe inovacioni për nxënësit dhe fermerët.

Në aktivitet mori pjesë ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Andis Salla, i cili vlerësoi projektin si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të

shpreh Salla, duke theksuar se qeveria po vijon investimet në ujitje-kullim, teknologji moderne dhe dixhitalizim të shërbimeve për fermerët.

Ai nënvizoi gjithashtu se shumë shpejt do të vihet në funksion një paketë e re dixhitalizimi për bujqësinë, e cila

## Rama: Nga biznes familjar në histori suksesi, 80 punonjës dhe katër mijë klientë çdo ditë

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë në Gjirokastër në sipërmarrjen "Alegria", duke e cilësuar atë si një shembull domethënës të sukses-

dhe forma të reja paketimi.

Ndër risitë më të fundit janë formatet unike të paketimit, të njohura si "kampet", të cilat sipas drejtuesve të kompanisë nuk ekz-

linja automatike për prodhimin e produkteve të reja, si kokoshkat e karamelizuara.

Një pjesë e rëndësishme e lëndës së parë sigurohet nga fermerët e zonës, duke krijuar një zinxhir të qëndrueshëm ekonomik dhe duke mbështetur ekonominë lokale në qarkun e Gjirokës.

Aktualisht, kompania numëron mbi 80 punonjës dhe shërben për më shumë se katër mijë klientë çdo ditë, duke u kthyer në një nga punëdhënësit më të rëndësishëm në zonë.

Gjatë vizitës, Kryeministri Rama vlerësoi rolin e sipërmarrjeve të tilla në promo-



it të biznesit familjar shqiptar dhe potencialit të produkteve "Made in Albania" në tregjet ndërkombëtare.

Kompania "Alegria" ka arritur të dhjetëfishojë eksportet e saj brenda pak vitesh, duke depërtuar në tregje si Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar, si dhe duke zgjeruar praninë në tregjet e Lindjes, ku kërkesa për produkte tradicionale shqiptare është në rritje.

E nisur si një fabrikë e vogël familjare, sot sipërmarrja është transformuar përmes investimeve në teknologji të reja dhe inovacion, duke sjellë produkte të standardeve bashkëkohore



istojnë ende në tregun rajonal.

Baza e prodhimit mbetet e lidhur fort me traditën, ku përfshihen produkte si jufka, petë dhe trahana, ndërsa së fundmi kompania ka investuar edhe në

vimin e produkteve shqiptare dhe në zhvillimin e ekonomisë vendase, si dhe theksoi rëndësinë e mbështetjes së inovacionit dhe eksportit në vitet në vijim.

## Grumbulluesit dhe përpunuesit bujqësorë, nën monitorim të shtuar për respektimin e faturimit tatimor

Në prag të procesit të aplikimeve për kompensimin e fermerëve, i cili nis më 1 korrik, Administrata Tatimore ka marrë ankesa nga fermerët lidhur me moslëshimin e auto-faturave nga subjektet grumbulluese.

Në këtë kuadër, Administrata Tatimore bën të ditur se do të ndërmarrë verifikime të thelluara në të gjithë zinxhirin e sektorit bujqësor.

Sipas DPT-së, kontrollet do të përqendrohen te subjektet grumbulluese dhe përpunuese, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre zhvillohet në përputhje me legjislacionin tatimor, nëse lëshohen faturat përkatëse dhe për të identifikuar raste të mundshme të përdorimit të NIPT-eve fiktive.

Paralelisht, do të verifikohen edhe fermerët e regjistruar me NIPT, për të përcaktuar nëse ushtrojnë realisht aktivitet bujqësor apo nëse bëhet fjalë për regjistrime fiktive.

Administrata Tatimore thekson se do të ndërmarrë masa administrative ndaj çdo subjekti që nuk respekton detyrimin për lëshimin e auto-faturave tatimore për blerjet e produkteve bujqësore nga fermerët, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Njëkohësisht, DPT sjell në vëmendje se fermerët përfitojnë kompensim për furnizimet e mallrave apo shërbimeve të kryera ndaj personave të tatueshëm të regjistruar për TVSH, të cilët ushtrojnë aktiv-

itet si grumbullues, përpunues të produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar, sipas legjislacionit në fuqi për turizmin dhe që nuk janë përfutur të skemës së kompensimit.

Norma e kompensimit është 10% e vlerës totale të produkteve të furnizuara nga prodhuesi bujqësor, të dokumentuara me faturë tatimore, përgjatë një periudhe 6-mujore.

"Për këtë arsye, u bëhet thirrje të gjithë fermerëve që

të kërkojnë faturën tatimore për çdo shitje të kryer ndaj subjekteve grumbulluese, përpunuese apo agroturizme të certifikuar, në mënyrë që të përfitojnë të drejtën e kompensimit", deklaroi DPT.

Administrata Tatimore siguroi se mbetet e angazhuar në forcimin e formalizimit të ekonomisë, rritjen e transparencës dhe garantimin e konkurrencës së ndershme në treg.

### GRUMBULLUESIT DHE PËRPUNUESIT BUJQËSORË NËN MONITORIM TË SHTUAR

PËR RESPEKTIMIN E FATURIMIT TATIMOR

- VERIFIKIME TË THELLUARA** në të gjithë zinxhirin e sektorit grumbullues dhe përpunues.
- KONTROLL PËR LËSHIMIN E AUTO-FATURAVE** për blerjet e produkteve bujqësore nga fermerët.
- EVIDENTIM I NIPT-EVE FIKTIVE DHE AKTIVITETIT REAL** i grumbulluesve, përpunuesve dhe fermerëve.
- MASA ADMINISTRATIVE** ndaj çdo subjekti që nuk respekton detyrimin për lëshimin e faturës tatimore.
- FERMERËT PËRFITOJNË 10% KOMPENSIM** mbi vlerën e furnizimeve të dokumentuara me faturë tatimore, përgjatë një periudhe 6-mujore.
- KËRKONI FATURËN TATIMORE** për çdo shitje të kryer ndaj subjekteve të regjistruara (grumbullues, përpunues ose agroturizëm i certifikuar).

APLIKIMET PËR KOMPENSIM NISIN MË 1 KORRIK

FORMALIZIM I EKONOMISË
 TRANSPARENÇË
 KONKURRENÇË E NDERSHME

Administrata Tatimore - Për një ekonomi të formalizuar dhe të zhvilluar.

## EU4Municipalities II, Demo: 11 milionë euro grante dhe asistencë teknike për infrastrukturën lokale dhe digjitalizimin

Në qytetin e Durrësit u lançua zyrtarisht programi strategjik EU4Municipalities II, një nismë që synon forcimin e pushtetit vendor dhe mbështetjen e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Europian.

Programi pritet të mbështesë bashkitë me investime konkrete, rritje të kapaciteteve institucionale dhe modernizim të shërbimeve për qytetarët.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ervin Demo, vlerësoi rëndësinë e projektit, duke theksuar se ai kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve publike dhe forcimin e administratës vendore.

"Në raundin e parë të këtij projekti Bashkia Berat, ka qenë përfutuese dhe përmirësimi i shërbimeve arsimore në këtë bashki u bë falë këtij projekti. Ndaj nisja e fazën së dytë të këtij programi është me shumë rëndësi, sepse Shqipëria vijon



rrugën drejt BE-së dhe kjo kërkon përmirësim të shërbimeve për qytetarët dhe forcim të kapaciteteve të bashkive", u shpreh Demo.

Sipas tij, programi me një financim prej 11 milionë eurosh do të mbështesë bashkitë në tre drejtime kryesore: grante për investime në infrastrukturë lokale, asistencë teknike për rritjen e kapaciteteve në thithjen dhe menaxhimin e projekteve të BE-së, si dhe digjitalizimin

e shërbimeve publike.

"Bashkitë e forta nënkuptojnë ekonomi lokale më të forta dhe përparim drejt Bashkimit Europian", theksoi ministri Demo.

Sipas tij, duke iu referuar edhe vlerësimeve të përfaqësuesve të BE-së, rreth 70% e legjislacionit europian zbatohet në nivel vendor, çka e bën thelbësore përgatitjen dhe fuqizimin e bashkive në këtë proces.

## SKEMA KOMBËTARE

# Grurë, misër, lopë, qumësht: Subvencionet në bujqësi 77.5 milionë euro për vitin 2026

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka miratuar Vendimin për Kornizat e Programit Vjetor 2026, me një buxhet prej 77.5 milionë euro për mbështetjen e sektorit të bujqësisë në Kosovë.

Ministria e Bujqësisë,

cialë deri në rreth 433 €/ha, pa përfshirë pagesën shtesë për hektarin e parë. Në kuadër të

## 1.2 Kulturat proteinike, vajore dhe industriale

**1.2.1 Luledielli** – Mbështetja për luledielli arrin deri në 454 €/ha, duke përfshirë pagesën bazë, mbështetjen për kulturë strategjike, masat për stabilizimin e tregut dhe mundësinë për mbështetje në kuadër të konvertimit organik. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse në favor të fermave të vogla dhe të mesme. Luledielli mbështetet për shkak të rëndësisë në prodhimin vendor të vajrave ushqimore, diversifikimin e kulturave bujqësore dhe reduktimin e varësisë nga importet.

**1.2.2 Fasulja** – Mbështetja për fasulën arrin deri në 754 €/ha, duke kombinuar pagesën bazë, mbështetjen e lidhur me prodhimin, masat për stabilizimin e tregut dhe mbështetjen për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse. Fasulja trajtohet si kulturë proteinike strategjike me rëndësi të veçantë për sigurinë ushqimore, zëvendësimin e importeve dhe rritjen e prodhimit vendor të produkteve me vlerë të lartë ushqyese.

**1.2.3 Patatja** – Mbështetja për patatën arrin deri në 754 €/ha, përmes kombinimit të pagesës bazë, pagesës së lidhur me prodhimin, masave për stabilizimin e tregut dhe mbështetjes për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse. Patatja konsiderohet kulturë strategjike për furnizimin vendor me ushqim, stabilitetin e tregut dhe mbështetjen e prodhimit bujqësor me orientim tregu.

## 2. PERIMET, PEMËTARIA DHE VRESHTARIA

### 2.1 Perimet dhe prodhimi intensiv

**2.1.1 Perimet në fushë të hapur** – Mbështetja standarde për perimet në fushë të hapur arrin në 704 €/ha, përmes pagesës bazë, pagesës së lidhur me prodhimin dhe mbështetjes për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/

ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse në favor të fermave të vogla dhe të mesme. Politika synon rritjen e prodhimit vendor, furnizimin më të qëndrueshëm të tregut dhe uljen e importeve sezonale të perimeve.

**2.1.2 Perimet në serra** – Mbështetja për prodhimin e perimeve në serra arrin në 1,054 €/ha, duke reflektuar nivelin më të lartë të investimeve, produktivitetit, intensitetit të prodhimit dhe punësimit në këtë sektor. Përfshihet edhe mundësia për 100 €/ha shtesë për hektarin e parë. Sektori i serrave konsiderohet prioritet strategjik për rritjen e prodhimit vendor gjatë gjithë vitit, modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve vendore.

### 2.2 Pemëtaria, vreshtaria dhe kulturat shumëvjeçare

**2.2.1 Pemet drufrutore, arvore dhe fruta te imta manore** – Mbështetja për pemëtarinë arrin deri në 654 €/ha, duke përfshirë pagesën bazë, mbështetjen për inpute dhe mundësinë për mbështetje shtesë në kuadër të prodhimit organik dhe konvertimit organik. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse. Pemëtaria konsiderohet sektor me potencial të lartë eksporti, vlerë të shtuar dhe zhvillim afatgjatë rural.

**2.2.2 Mjedra** – Kultivuesit e mjedres përfitojnë pagesë prej 0.20 €/kg për prodhimin e dorëzuar, si dhe mbështetje shtesë për sipërfaqen prej 150 €/ha. Për shkak të intensitetit të lartë të prodhimit, orientimit eksportues dhe vlerës së lartë tregtare, mbështetja totale për këtë kulturë mund të jetë dukshëm më e lartë se për kulturat tradicionale bujqësore. Sektori synon rritjen e eksporteve dhe forcimin e prodhimit me vlerë të shtuar.

**2.2.3 Vreshtaria** – Vreshtat mbështeten me 1,104 €/ha, përmes pagesës bazë, mbështetjes së lidhur me prodhimin dhe inputeve bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë. Përveç mbështetjes

për sipërfaqe, vera e prodhuar mbështetet me 0.08 €/litër, ndërsa fidanët e vreshtave me 0.15 €/njësi, me qëllim zhvillimin e industrisë së verës, modernizimin e vreshtarisë dhe rritjen e eksporteve të produkteve vendore.

**2.2.4 Bimët mjekësore dhe aromatike** – Mbështetja për bimët mjekësore dhe aromatike arrin deri në 504 €/ha, duke përfshirë pagesën bazë, mbështetjen për inpute dhe mundësinë për mbështetje shtesë për prodhim organik dhe konvertim organik. Përfshihet edhe mundësia për 100 €/ha shtesë për hektarin e parë. Ky sektor konsiderohet me potencial të lartë eksporti, diversifikimi ekonomik dhe zhvillimi rural, veçanërisht në zonat kodrinore dhe malore të Kosovës.

## 3. BLEGTORIA

### 3.1 Blegtoria bazë dhe riprodhimi

**3.1.1 Lopët qumështore** – Mbështeten me 90 €/kokë për të nxitur prodhimin vendor të qumështit dhe formalizimin e sektorit.

**3.1.2 Mëshqerrat për riprodhim** – Mbështeten me 60 €/kokë për të forcuar kapacitetet riprodhuese të fermave.

**3.1.3 Viçat** – Mbështeten me 30 €/kokë për zhvillimin e sektorit të mishit dhe ripërtëritjen e tufës.

Buallicat – Mbështeten me 180 €/kokë për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij sektori specifik blegtoral.

**3.1.4 Delet dhe dhitë** – Mbështetja për delet dhe dhitë për mbarështrim është 30 €/kokë, me fokus në zonat rurale dhe malore.

### 3.2 Shpezëtaria

**3.2.1 Pulat dhe brojlerët** – Pulat mbështeten me 0.50 €/kokë dhe brojlerët me 0.20 €/kokë, për të mbështetur prodhimin vendor të vezëve dhe mishit të shpezëve. Ky sektor mbështetet për shkak të rolit të rëndësishëm në furnizimin e tregut vendor me proteina shtazore dhe po-

tencialit për rritje të prodhimit vendor.

### 3.3 Derrat

**3.3.1 Dosat për riprodhim mbështeten me 25 €/kokë për stabilizimin e sektorit të dërrtarisë, rritjen e prodhimit vendor dhe forcimin e kapaciteteve riprodhuese në fermat blegtorale.**

## 4. CILËSIA DHE DIVERSIFIKIMI I PRODHIMIT

**4.1 Cilësia dhe formalizimi i prodhimit të qumështit** – Qumështi – Pagesa realizohet sipas klasës së cilësisë:

- 0.07 €/litër për Klasën Extra
- 0.04 €/litër për Klasën I
- 0.02 €/litër për Klasën II

Kjo skemë synon rritjen e cilësisë, formalizimit dhe standardeve të sigurisë ushqimore në sektorin e qumështit.

### 4.2 Bletaria

**4.2.1 Bletaria** – Kosheret mbështeten me 25 €/koshere, ndërsa bletaria organike me 30 €/koshere, duke mbështetur prodhimin vendor të mjaltit dhe biodiversitetin.

### 4.3 Akuakultura

**4.3.1 Akuakultura** – Prodhimi i peshkut mbështetet me 0.25 €/kg për të nxitur zhvillimin e akuakulturës dhe diversifikimin e ekonomisë rurale.

Njësitë e pritura, normat orientuese dhe alokimet individuale të paraqitura në kuadër të këtyre orientimeve indikative përbëjnë bazën orientuese për grupet punuese përgjegjëse për hartimin, konsultimin dhe finalizimin e Programit Vjetor për Pagesa Direkte dhe akteve përkatëse nënligjore. Këto orientime janë ndërtuar mbi analizat sektoriale, prioritetet e politikave bujqësore, nevojat për siguri ushqimore, zhvillim rural dhe rritje të prodhimit vendor, si dhe mbi kapacitetet buxhetore të programuara për vitin 2026. Në këtë fazë, normat dhe alokimet kanë karakter indikativ dhe mund të rishikohen gjatë procesit të finalizimit të programit, në varësi të rezultateve të konsultimeve, numrit të aplikuesve të pritshëm dhe prioritetive zhvillimore të sektorit agro-ushqimor.

"Monitor"



Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se javën e kaluar ka nënshkruar orientimet indikative të Programit të Pagesave Direkte (subvencioneve) në bujqësi për vitin 2026, të strukturuar sipas sektorëve strategjikë dhe zinxhirëve kryesorë agro-ushqimorë, në përputhje me metodologjinë sektoriale të Bashkimit Evropian.

Sipas tij, programi kombinon pagesën bazë, pagesat e lidhura me prodhimin për kultura prioritare, masat për stabilizimin e tregut, pagesën rishpërndarëse për hektarin e parë dhe eko-skema, me synim rritjen e prodhimit vendor, forcimin e sigurisë ushqimore, zhvillimin rural të qëndrueshëm dhe rritjen e eksporteve agro-ushqimore.

## 1. SIGURIA USHQIMORE DHE KULTURAT STRATEGJIKE

### 1.1 Drithërat

**1.1.1 Gruri** – Mbështetja standarde për grurin arrin në 304 €/ha, përmes pagesës bazë, masave për stabilizimin e tregut dhe mbështetjes për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse në favor të fermave të vogla dhe të mesme. Përveç kësaj, fermerët përfitojnë pagesë shtesë prej 0.04 €/kg, bazuar në prodhimin dhe rendimentin e realizuar. Me një rendiment orientues prej 3,225 kg/ha, kjo përkthehet në rreth 129 €/ha mbështetje shtesë, duke e çuar mbështetjen totale poten-

programit parashihet gjithashtu mbështetje specifike për prodhimin e farës së grurit, me qëllim forcimin e sigurisë ushqimore, rritjen e cilësisë së materialit mbjellës dhe zhvillimin e zinxhirit vendor të furnizimit me farë cilësore.

**1.1.2 Misri** – Mbështetja për misrin arrin në 329 €/ha, përmes pagesës bazë, mbështetjes për kultura strategjike, masave për stabilizimin e tregut dhe mbështetjes për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse në favor të fermave të vogla dhe të mesme. Misri trajtohet si kulturë strategjike me rëndësi të veçantë për sigurinë ushqimore, furnizimin e industrisë ushqimore dhe sektorin blegtoral, duke pasur rol kyç në prodhimin vendor të ushqimit për njerëz dhe për kafshë.

**1.1.3 Elbi, tërshëra dhe thekra** – Mbështetja standarde për këto kultura arrin në 304 €/ha, përmes pagesës bazë, masave për stabilizimin e tregut dhe mbështetjes për inpute bujqësore. Fermerët mund të përfitojnë edhe 100 €/ha shtesë për hektarin e parë, si pagesë rishpërndarëse në favor të fermave të vogla dhe të mesme. Këto kultura mbështeten për shkak të rolit të tyre të rëndësishëm në furnizimin e sektorit blegtoral, diversifikimin e prodhimit bujqësor dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik të zonave rurale, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e prodhimit vendor dhe sigurinë ushqimore.

# Rama: Mbështetja për dyfishimin e SME-ve, garanci për vende të reja pune

gjithçka është e mundur për të mbështetur të gjithë ata njerëz që i besojnë sipërmarrjes së lirë dhe ndërmarrjeve të tyre të vogla e të mesme.

"Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë partnerët tanë më të rëndësishëm në krijimin

e vendeve të punës për të mbështetur familjet dhe sigurisht për të krijuar hapësirë për të rinjtë që të rriten", u shpreh Rama.

Duke folur për marrëveshjen e firmosur, Rama theksoi se ajo synon të

mbështesë programin e madh për dyfishimin e sipërmarrjeve të vogla e të mesme.

"Ajo çfarë e bën të rëndësishme këtë hyrje të Bankës Evropiane të investimeve së bashku me bankën Intesa Sanpaolo nuk është thjesht vlera

e parave. Është mundësia për të bërë maksimumin për të përfituar prej tyre përvojën që kanë krijuar në kaq shumë vite në mbështetje të shteteve anëtare", u shpreh Rama.

Kryeministri theksoi se Banka Shqiptare e Zhvillimit

që sapo është krijuar, është një instrument i ri që do të shërbejë si urë midis qeverisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve.

"Po pres me padurim që të forcojmë bashkëpunimin me Bankën Evropiane të Investimeve. Së pari për të marrë sa më shumë të jetë e mundur nga dija juaj e jashtëzakonshme dhe së dyti sigurisht për t'ju bërë të investoni më shumë në Shqipëri", shtoi Rama.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



## Jaupaj: Iniciativë rajonale me Maqedoninë e Veriut për pyjet, 50 milionë dollarë investim

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj zhvilloi një takim me Dame Dimitrovskin, këshilltar i kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, si dhe Raimund Jehle, përfaqësues i FAO-s, në kuadër të konferencës rajonale "United for Climate" (Të bashkuar për klimën).

Jaupaj nënvizoi se gjatë takimeve me ta, u diskutua avancimi i një iniciative rajonale për sektorin pyjor, e mbështetur nga Green Climate Fund dhe FAO.

Sipas tij, iniciativa synon restaurimin e pyjeve, monitorimin modern të territorit, menaxhimin e riskut nga zjarret, si dhe forcimin e kapaciteteve të vendeve të rajonit për t'u përballur me efektet e ndryshimeve klimatike.

Projekti parashikon një investim prej 50 milionë

Gjatë takimit, pjesëmarrësit vlerësuan se bash-



dollarësh për sektorin pyjor në rajon, duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe mbrojtjen afatgjatë të ekosistemeve pyjore në Ballkanin Perëndimor.

këpunimi rajonal mbetet një element kyç për ndërtimin e një Ballkani Perëndimor më të qëndrueshëm, më të sigurt dhe më pranë standardeve europiane në fushën e klimës dhe mjedisit.

## Jaupaj: 40 milionë euro për Shqipërinë nga Fondi Global i Mjedisit

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj u shpreh se Shqipëria ka siguruar një projekt prej 40 milionë dollarësh për ndryshimet klimatike, në kuadër të programit "Albadap", që konsiderohet si projekti më i madh i klimës që po zbatohet në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë një konference për shtyp me gazetarët, Jaupaj tha se asnjë vend tjetër i Bashkimit Evropian apo i Ballkanit Perëndimor nuk ka aktualisht një projekt të tillë të financuar nga Fondi Global i Mjedisit.

Duke u ndalur te konferenca treditore e klimës, që solli në Shqipëri përfaqësues të institucioneve evropiane dhe organizatave botërore të mjedisit, Jaupaj nënvizoi se "rezultatet e kësaj konference ishin krejt pozitive për vendin tonë. Kjo platformë do të vazhdojë të zhvillohet çdo vit në Shqipëri, duke e çuar vendin tonë në një pozicion lider sa i takon ndryshimeve klimatike

në Ballkanin Perëndimor".

"Shqipëria ka marrë gjithashtu garancinë për financimin e një projekti tjetër në sektorin e pyjeve, me vlerë 50 milionë dollarë, me mbështetjen e Maqedonisë së Veriut. Financimi do të jetë grant dhe pritet të miratohet nga Fondi i Gjelbër Global i Klimës", tha ai.

Sipas Jaupajt, fondet do të përdoren për zgjerimin e fidanishteve, rryllëzimin e zonave të dëmtuara nga zjarret dhe erozioni, si edhe për rritjen e kapaciteteve në administrimin e pyjeve.

Ministri njoftoi se ministria që ai drejton ka miratuar krijimin e katër agjencive rajonale të pyjeve, me synimin për të rritur praninë në territor dhe për të ndihmuar bashkitë në planet e menaxhimit pyjor. Ai theksoi se do të krijohet ndërmarrja shtetërore e pyjeve, model që, sipas tij, aplikohet në disa vende të Evropës.

Sipas Jaupajt, në tetor të vitit 2025, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Kadashtren Shqiptare përfundoi regjistrimin e të gjithë fondit pyjor të Shqipërisë, i cili përbëhet nga rreth 1,2 milionë hektarë pyje. Sipas tij, kjo përfaqëson një mesatare të lartë krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian.

"Rikthimi i fidanishteve shtetërore është një domosdoshmëri kombëtare, sepse duhet të zgjerohet rryllëzimin e territoreve të degraduara nga zjarret dhe erozioni, por edhe të shtojmë sipërfaqet pyjore pranë infrastrukturës rrugore", tha Jaupaj.

Gjatë konferencës u prezantua edhe Plani Kombëtar i Ndryshimeve Klimatike 2026-2036, i cili parashikon 66 masa prioritare për të rritur qëndrueshmërinë e vendit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, përfshirë zjarret dhe përmbajtjet.

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj prezantoi Planin Kombëtar për Ndryshimet Klimatike 2026-2036, i cili parashikon 66 masa prioritare për përballimin e efekteve të krizës klimatike në vend, si zjarret, përmbajtjet dhe thatësitrat.

Gjatë konferencës për shtyp me gazetarët, Jaupaj tha se masat janë të ndara në ndërhyrje të buta, masa të gjelbra dhe investime infrastrukturore, ndërsa kostoja totale e planit arrin në rreth 9,8 miliardë dollarë.

"Financimi shtetëror për mjedisin po rritet, por mbetet i pamjaftueshëm. Për këtë arsye kemi prezantuar planin pranë Komisionit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare që ofrojnë grante apo

kredi, me synimin për të ndërtuar një plan të qëndrueshëm financimi", u shpreh Jaupaj.

Një tjetër reformë që pritet të nisë lidhet me modernizimin e sistemit hidrometeorologjik në vend. Ministri Jaupaj tha se shumë stacione meteo dhe hidrologjike janë degraduar ndër vite për shkak të mungesës së investimeve dhe mirëmbajtjes.

Në këtë kuadër, sipas tij, është krijuar një bashkëpunim me operatorin zviceran të hidrometeorologjisë, MeteoSwiss, për të realizuar një reformë të plotë të sistemit.

Projekti synon shtimin e stacioneve monitoruese dhe



## Jaupaj takon homologun malazez, në fokus bashkëpunimi për liqenin e Shkodrës

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj priti në takim bilateral homologun nga Mali i Zi,

të mira mes dy vendeve dhe angazhimi i përbashkët për mbrojtjen e mjedisit dhe

ekosistemeve ndërkufitare, me fokus të veçantë te liqeni i Shkodrës dhe lumi Buna, si dhe mbi menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Një tjetër pikë e rëndësishme e bisedimeve ishte koordinimi në kuadër të Kapitullit 27 të acquis të Bashkimit Evropian dhe zbatimi i Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

"Gjatë takimit u vlerësua se shkëmbimi i eksperiencave dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta rajonale mbeten thelbësore për një të ardhme më të gjelbër, më të qëndrueshme dhe më të integruar evropianisht për rajonin", tha ministri Jaupaj.



Damjan Ćufalić, në kuadër të konferencës ndërkombëtare United for Climate, që u zhvillua në Tiranë.

Gjatë takimit u riafirmuan marrëdhëniet shumë

avancimin e procesit të integritit evropian.

Jaupaj tha se në fokus të takimit me ministrin Ćufalić, ishte forcimi i bashkëpunimit për mbrojtjen e

## Rregulla të reja për dhënien me qira të zonave të gjuetisë - Kontratat afat 5-vjeçar, bashkia përcakton fituesin përmes një sistemi pikëzimi

Qeveria ka përcaktuar rregulla dhe kritere të reja për dhënien me qira të zonave të gjuetisë në Shqipëri.

Projektvendimi për "përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit", i hedhur për konsultim publik, synon të krijojë një kuadër të qartë, transparent dhe të zbatueshëm për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit, duke garantuar një menaxhim të qëndrueshëm të faunës së egër dhe përfshirjen e aktorëve lokalë.

Sipas dokumentit, ndër përparësitë kryesore të projektvendimit është vendosja e rregullave të standardizuara për konkurrimin publik, rritja e kontrollit institucional dhe formalizimi i aktivitetit të gjuetisë, duke kontribuar në mbrojtjen e biodiversitetit dhe në zhvil-

limin ekonomik lokal përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Projektvendimi, trajton detyrimin e njësisive të vetëqeverisjes vendore që, pas shpalljes së zonave për gjueti, mbarështim ose ripopullim, të fillojnë brenda një afati të caktuar procedurën për dhënien e tyre me qira nëpërmjet një procesi konkurrimi publik.

Po ashtu, dokumenti përcakton detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen me urdhër të një komisioni, i cili ngarkohet me ndjekjen dhe administrimin e procedurave të konkurrimit publik.

Drafti, jep rregullat për publikimin e shpalljes për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit ose ripopullimit, afatet e publikimit, si dhe elementet e detyrueshme që duhet të përmbajë njoftimi për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik nga ana tjetër parashikon detyrimin e

çdo subjekti pjesëmarrës për të paraqitur dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kriterëve ligjore për marrjen në përdorim të zonave përkatëse.

Kërkesa për pjesëmarrje në konkurrim, përfshin të dhënat e subjektit, ofertën financiare dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe kategorinë e zonës për të cilën aplikohet.

Mënyra e vlerësimit të ofertave bëhet nga një komisioni i posaçëm përmes sistemit të pikëzimit dhe kryetari i bashkisë vendos dhe shpall fitues subjektin me pikët më të larta, për lidhjen e kontratës së qirasë pas përfundimit të procesit të vlerësimit.

Pas përfundimit të procedurave, bashkia shpall publikisht fituesin dhe lidh kontratën e qirasë me afat 5-vjeçar, jo më vonë se fillimi i sezonit të gjuetisë dhe vlera e qirasë nuk mund të jetë më e ulët se vlera fillestare e përcaktuar.

## Jaupaj: Shqipëria, plan 10-vjeçar me 66 masa për cilësinë e ajrit dhe klimën

Projekti synon shtimin e stacioneve monitoruese dhe

ndërtimin e një sistemi më të saktë për parashikimin e

fenomeneve atmosferike dhe rreziqeve natyrore.

"Objektivi është që gjatë viteve 2027-2028 të kemi kalibrimin funksional të sistemit sipas standardeve evropiane", deklaroi Jaupaj.

Ministri Jaupaj u ndal edhe te problematika e cilësisë së ajrit, të cilën e cilësoi si një nga kapitujt më sfidues në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian. Ai përmendi Tiranën, Elbasanin, Durrësin dhe Korçën si qytete problematike për ndotjen e ajrit.

Sipas tij, Ministria e Mjedisit ka nxjerrë për konsul-

tim publik paketën e re për cilësinë e ajrit, e cila përfshin strategjinë kombëtare 10-vjeçare, planin e veprimit dhe projektligjin e ri të harmonizuar me direktivat evropiane.

Jaupaj bëri të ditur se ka nisur bashkëpunimi me Bankën Botërore për financimin e një projekti të plotë monitorimi të cilësisë së ajrit. Projekti parashikon ngritjen e një qendre kombëtare monitorimi dhe vendosjen e stacioneve të matjes sipas standardeve të Agjencisë Evropiane të Mjedisit.

Ministri nënvizoi se synimi është që deri në vitin 2028 Shqipëria të ketë një sistem të plotë monitorimi të cilësisë së ajrit, në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian.

INFORMACIONE

# Jaupaj: Markim dhe mirëmbajtje të “Shtegut të Pelikanit” në Divjakë-Karavasta

Në “Shtegun e Pelikanit” në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta këtë fundjavë Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Ministrinë e Arsimit, nisën programin “Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura”.

Kjo nismë synon mbrojtjen e mjedisit dhe mirëmbajtjen e shtigjeve turistike në të gjithë vendin.

Ministri i Mjedisit Sofjan Jaupaj, në një postim në rrjetet sociale, tha se kjo iniciativë i sjell nxënësit më pranë natyrës, duke i bërë pjesë aktive të markimit, sistemimit dhe mirëmbajtjes së shtigjeve turistike në zonat e mbrojtura.

Jaupaj u shpreh se përmes ekskursioneve dhe orëve mjedisore në terren, të rinjtë mësojnë jo vetëm të njohin biodiversitetin e vendit tonë, por edhe ta mbrojnë atë.

“Edukimi mjedisor fillon në terren, aty ku natyra bëhet klasa më e mirë për brezin e ri”, tha Jaupaj.

Programi kombëtar “Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura” synon të krijojë një kulturë të bashkëpunimit mes institucioneve dhe qytetarëve, duke e kthyer mbrojtjen e natyrës në një prioritet të përbashkët kombëtar.

Shtigjet turistike në Shqipëri po kthehen gjithnjë e më shumë në destinacione të preferuara për vizitorët vendas



dhe të huaj, falë bukurisë natyrore dhe mundësive për ecje, aventurë dhe eksplorim. Rritja e interesit për turizmin malor

dhe aktivitetet në natyrë ka sjellë edhe nevojën për kujdes dhe mirëmbajtje më të madhe të këtyre hapësirave.

# Pranvera në Erind të Lunxhërisë, fshati ku bujqësia, blegtoria dhe tradita mbeten shtylla të jetës

Pranvera i ka dhënë më shumë gjallëri fshatit Erind, në Lunxhëri. Mes gjelbërimit dhe natyrës së pasur, ky fshat vijon të mbetet i gjallë falë lidhjes së fortë të banorëve me tokën dhe traditën.

“Fshati Erind ka rreth 60-70 shtëpi, ka rreth 400 banorë. Të gjithë janë të lidhur me punën. Këtu punohet shumë bujqësia dhe blegtoria. Në këtë periudhë njerëzit merren me mbjellje, mbjellje perimesh, domate, speca, patëllxhanë. Njëkohësisht bëhet edhe spërkatja” – u shpreh kryetari i fshatit, Shaqo Bojo.

Bujqësia dhe blegtoria janë burimi kryesor i jetesës për familjet e zonës. Banorët tregojnë se puna në tokë dhe rritja e bagëtive mbeten baza e ekonomisë së tyre.

“Më shumë merren me bujqësi, me gjëra të vogla. Një pjesë që kanë bagëti, pjesa tjetër kanë ikur emigrantë, kanë mbetur vetëm një pjesë pleq tani këtu. Unë punoj në ndërtim. Ka kërkesa por nuk ka forcë punëtore. Jetesa është siç ta bësh. Fshati ynë është ‘balli’ i fshatrave se ka klimë, ka çdo gjë, ka ajrin”.

Afërsia me malin e Çajupit, objektet e kultit dhe mikpritja tradicionale po e kthejnë Erindin në një destinacion gjithnjë e më tërheqës për vizitorët.

Mes natyrës, traditës dhe punës së palodhur, Erindi mbetet një nga fshatrat që vazhdon të jetojë dhe të zhvillohet në jug të vendit.



# Konferencë rajonale në Tiranë mbi qeverisjen gjithëpërfshirëse në zonat rurale dhe malore

Përfaqësues të bashkive, organizatave të shoqërisë civile, studiues, përfaqësues të të rinjve dhe aktorë komunitarë nga Shqipëria, Italia dhe Portugalia u mbledhën në Tiranë për të shkëmbyer përvoja dhe praktika të mira lidhur me pjesëmarrjen demokratike, angazhimin qytetar dhe qeverisjen gjithëpërfshirëse në zonat rurale dhe malore.

Konferenca “Mountain Voices for Engaged and Sustainable Democracy” (MOVES) u organizua nga organizata “People in Focus” në kuadër të Projektit MOVES, i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit Citizens, Equality, Rights and Values (CERV).

Sesioni hapës përfshiu fjalët e mirëseardhjes nga Armeilia Barci, drejtore ekzekutive e People in Focus Albania, e cila prezantoi objektivat e projektit MOVES dhe theksoi rëndësinë e forcimit të pjesëmarrjes demokratike dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve lokale dhe institucioneve në të gjithë Evropën.

Gjatë panelit të parë tematik, pjesëmarrja e përfaqësuesve nga disa bashki shqiptare dhe italiane kontribuoi me njohuri të vlefshme mbi praktikën e qeverisjes vendore, nismat e angazhimit qytetar dhe riaktivizimit të qytetarëve përmes qasjeve komunitare dhe mjedisore.

Angelo Mattoccia, kryetar i bashkisë së Pofi-t, rajoni i Lazio-s, prezantoi përvoja lokale mbi angazhimin qytetar dhe riaktivizimin e komunitetit përmes nismave mjedisore, duke theksuar rolin e bashkive në nxitjen e pjesëmarrjes aktive dhe përfshirjes së komunitetit.

Konferenca trajtoi qasje të qeverisjes që promovojnë përfshirjen, transparencën, bashkëpunimin dhe marrëdhënie më të forta midis institucioneve dhe komuniteteve, duke theksuar rëndësinë e qeverisjes

pjesëmarrje qytetare. Diskutimet theksuan nevojën për qasje të udhëhequra nga komuniteti dhe politika që synojnë krijimin e territoreve më rezistente dhe të qëndrueshme.



pjesëmarrëse në adresimin e sfidave të zhvillimit lokal dhe forcimin e kohezionit social.

Në panelin e dytë tematik të fokusuar në komunitetet malore, Chiara Mirabella, menaxhere projektesh e BE-së në “Norema” Srl, prezantoi perspektiva mbi angazhimin komunitar në zonat malore dhe theksoi rëndësinë e forcimit të pjesëmarrjes lokale në ndërtimin e së ardhmes më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për territoret evropiane.

Sesioni vijoi me shkëmbime mbi zhvillimin rural dhe malor, ku pjesëmarrësit reflektuan mbi sfida strukturore si depopullimi, kapaciteti i kufizuar institucional, barrierat e aksesit dhe mundësitë e reduktuara për

Vëmendje e veçantë u kushtua shkëmbimit të praktikave të mira nga kontekste të ndryshme evropiane, ku pjesëmarrësit ndanë përvoja lidhur me pjesëmarrjen qytetare, qeverisjen lokale, reziliencën komunitare dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial.

Konferenca u strukturua si një platformë transnacionale shkëmbimi, duke kombinuar panele tematike, prezantime, diskutime dhe sesione pune bashkëpunuese.

Projekti MOVES do të pasojë me zhvillimin e kapaciteteve dhe ndërtimin e modeleve konkrete të praktikave për t’u replikuar në të treja vendet pjesëmarrëse Shqipëri, Itali, Portugali.

# Rezervuarët arrijnë kapacitetin maksimal, ujë i mjaftueshëm për vaditje në Korçë, fermerët optimistë për prodhimin bujqësor

Ujëmbledhësi i Gjançit, një ndër më të mëdhenjtë në zonë, ka arritur plotësisht kapacitetin e tij, duke garantuar furnizim të qëndrueshëm për të gjitha sipërfaqet bujqësore që mbulon.

Të dy krahët e kanalit vaditës funksionojnë normalisht, duke çuar ujë në tokat nga Pulaha deri në Melçan dhe nga Floqi deri në Drenovë.

Fermerët theksojnë se kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e prodhimit bujqësor, sidomos për kulturat kryesore si perimet, drufrutorët dhe misri.

“Po si vjet viti s’ka qenë i keq”, u shpreh një fermer.

Ndërkohë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në bashkinë Korçë ka marrë masa shtesë

për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve vaditëse, duke siguruar shpërndarje efikase të ujit në çdo parcelë. Aktualisht, në qarkun e Korçës janë në admin-

istritim rreth 120 rezervuarë, të cilët këtë vit kanë arritur kapacitetin e plotë, duke krijuar kushte optimale për një sezon bujqësor të suksesshëm.



## LEGJISLACION

## Ndryshojnë tarifën shtetërore, zero kosto për testimin e farërave të reja, miratohen çmimet e reja për analizat e ujit të ambalazhuar

Në një lëvizje që synon të lehtësojë procedurat për agrobiznesin dhe të rrisë standardet e sigurisë ushqimore, qeveria ka rishikuar tarifën e shërbimeve që ofrohen nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Përmasat e ndryshimit të Përbashkët, të firmosur nga Ministri i Bujqësisë, Andis Salla, dhe Ministri i Financave, Petrit Malaj, janë përcaktuar rregulla

nëve (ESHFF) nuk do të aplikojë asnjë tarifë për testimin që bëhen me qëllim regjistrimin e këtyre varieteteve në Katalogun Kombëtar.

Kjo përjashton nga pagesa edhe testimin e avancuar të bazuar në standardet ndërkombëtare të UPOV (Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve) dhe CPVO. Ekspertët e bujqësisë e vlerësojnë këtë hap si një nx-

del në treg t'i nënshtrohet një kontrolli rigoroz laboratorik mbi përbërjen e tij.

Tashmë janë përcaktuar tarifën fikse për 9 tregues specifikë të ujit, ku ndër më kryesorët vlen të përmenden:

Fortësia e përgjithshme e ujit- 800 Lekë

Përmbajtja e klorureve- 700 Lekë

Nivelet e kalciumit dhe magnezit- Nga 600 Lekë secila

Mbetja e thatë (në 180°C)- 720 Lekë

Niveli i pehashit (pH)- 320 Lekë

Gazi karbonik- Nga 200 deri në 650 Lekë, në varësi të metodës (me aparat apo titrim).

### Tarifa të reja për etiketimin e prodhimit vendas

Shtylla e tretë e këtij vendimi riorganizon tarifën e certifikimit për materialin mbjellës të prodhuar brenda vendit. Për të shmangur burokracitë dhe për të qartësuar kostot për prodhuesit vendas, udhëzimi unifikon pagesën për lëshimin e etiketave zyrtare.

Nga tani e tutje, certifikimi dhe pajisja me etiketa zyrtare për farërat e bimëve të arave, bimëve foragjere dhe patates, do t'i kushtojë prodhuesve vetëm 500 Lekë për çdo sasi nga 1 deri në 100 kuintalë (kV) të certifikuar.

itje thelbësore për përmirësimin gjenetik të bimëve në Shqipëri dhe afrimin e prodhimit vendas me tregjet evropiane.

### Filtër i ri për ujin e ambalazhuar

Në një kohë kur konsumi i ujit të ambalazhuar është rritur ndjeshëm, shteti ka vendosur të detajojë dhe standardizojë tarifën për analizat fiziko-kimike të këtij produkti thelbësor. Kjo garanton që çdo markë uji që



të reja financiare që prekin drejtpërdrejt fermerët, prodhuesit e farërave dhe kompanitë e ambalazhimit të ujit.

Dokumenti, i cili ndryshon udhëzimin bazë të vitit 2022, fokusohet në tre shtylla kryesore. Ndryshimi më i rëndësishëm dhe më lehtësues për sektorin bujqësor është heqja e plotë e tarifave për testimin e varieteteve të reja bimore. Sipas udhëzimit të ri, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fida-

## Mbrojtja e faunës në Liqenin e Ohrit, shpallet ndalimi i peshkimit për sezonin e riprodhimit 2026

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nxjerrë Urdhrin, i cili sanksionon ndalimin e menjëhershëm të peshkimit në liqenin e Ohrit për disa lloje peshqish. Ky vendim vjen si një masë e domosdoshme për të garantuar procesin e riprodhimit natyror të faunës ujore, me fokus të veçantë te krapit dhe gjuhca.

Sipas udhëzimit të nënshkruar nga Ministri Andis Salla, kufizimet nisin nga data 20 prill dhe do të zgjasin deri në mesin e verës, duke përfshirë rregulla strikte për mjetet e gjuetisë dhe zonat e lejuara.

Ndalimi specifikon pushimin e çdo aktiviteti peshkimi (përveç peshkut Koran) në afatet e mëposhtme:

Gjuhca (Cironka) nga 20 prilli deri më 20 korrik 2026.

Krapit nga 20 prilli deri më 20 korrik 2026.

Zona breglindore nga 20 korriku deri më 20 gusht, ndalohej rreptësisht peshkimi me rrjeta

në fashën prej 300 metrash nga bregu.

“Ky urdher synon mbrojtjen e ciklit jetësor të specieve autoktone dhe koordinimin e veprimtarive teknike për grumbullimin e riprodhuesve në Qendrën e Linit,” thuhet në tekstin e urdhrin.

### Menaxhimi i riprodhimit dhe monitorimi

Për të siguruar vazhdimësinë e popullatës së krapit, Drejtoria e Shërbimeve të

Peshkimit do të koordinojë një operacion të veçantë me Qendrën e Prodhimit të Rasateve në fshatin Lin. Për këtë qëllim, do të angazhohen jo më shumë se 20 peshkatarë me përvojë, të cilët do të lejohen të peshkojnë vetëm riprodhuesit e krapit nën mbikëqyrje teknike.

Gjithashtu, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Pogradec është ngarkuar me detyrën e zhvendosjes së vezëve të peshkut në rast se niveli i ujit në liqen pëson rënie, duke parandaluar tharjen e tyre.



## Rregulla të rrepta për peshkimin dhe akuakulturën, ministria e Bujqësisë nis monitorimin me 6 faza për kontratat në të gjithë vendin

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar një udhëzim të ri, i cili reformon rreptësisht mënyrën se si shteti do të monitorojë shfrytëzimin e pasurive ujore në Shqipëri. Dokumenti i firmosur nga

pektoratin e Peshkimit, do të verifikojë nëse janë ndërtuar vaskat, inkubatorët, laboratorët apo magazinat frigoriferike të deklaruara në plan-biznes; verifikimi i numrit real të punonjësve përmes deklarat-

rrjeta); analiza e faturave të blerjes/shitjes dhe dokumenteve ligjore brenda 15 ditëve (30 ditë për OMP-të); hartimi i gjetjeve dhe evidentimi i shkeljeve të mundshme; subjektin i jepet 7 ditë kohë për të paraqitur pretendimet e tij; ministri miraton raportin përfundimtar, i cili mund të çojë në masa përmirësimi ose në zgjidhjen e kontratës në rast të rënda.

Ndonëse udhëzimi parashikon monitorime periodike (të paktën një herë në vit), ai i jep dorë të lirë strukturave shtetërore të ndërhyjnë në çdo kohë pa planifikim. Kjo do të ndodhë në rastet kur ka indicie, ankesa nga qytetarët apo informacione nga subjekte private për shkelje të mundshme të kushteve të kontratës apo ligjit për peshkimin.

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet rregullorja e mëparshme e vitit 2020. Ky ndryshim shënon një kthesë drejt digjitalizimit dhe dokumentimit të rreptë të aktivitetit peshkor, duke vendosur menaxhuesit e zonave përballë një llogaridhënieje më të lartë administrative.

Tashmë, çdo subjekt që operon në ujërat e brendshme apo në akuakulturë ka detyrimin jo vetëm të prodhojë, por të provojë përmes faturave dhe dokumentacionit ligjor çdo hap të aktivitetit të tij, nën vëzhgimin e ministrisë.



Ministri Andis Salla synon të unifikojë procesin e kontrollit për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në peshkimin në ujërat e brendshme dhe në akuakulturë.

Ky akt ligjor vjen si një masë për të garantuar që pasuria kombëtare ujore të përdoret me përgjegjësi, duke ndëshkuar abuzimet me sipërfaqet, metodologjitë e zënies dhe mospërmirësimin e investimeve të premtuara.

### Çfarë do të verifikohet në terren?

